



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER  
LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Njësitë: Unit: KO Nr. Prot.: Prct. No.: 11/2021  
Jediniça: Br. Prot.:  
Nr. i faqevo: No. of pages: -14- Data: Datum: 15.06.2021  
Br. stranica: Prishtinë



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**RREGULLORE PËR  
PROCEDURAT VENDIMARRËSE TË ORGANEVE  
TË OMK-së**

**Prishtinë,  
Qershor 2021**

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK)**, në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e profesionistëve shëndetësorë, nenit 22, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OMK-së, nenin 6, paragrafin 3 të Rregullores për Punën e Kuvendit, në mbledhjen e datës 15.06.2021 miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR PROCEDURAT VENDIMMARRËSE TË ORGANEVE TË OMK-së**

### **Kapitulli I - Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat e vendimmarrjes të organeve të OMK-së lidhur me ushtrimin e kompetencave që janë të parapara me Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, Statutin dhe aktet normative të OMK-së. Procedurat e vendimmarrjes përfshijnë: punën e organeve kolegjiale të Odës, përgatitjen dhe thirrjen e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, kryesimin e mbledhjeve, rendin dhe rregullin e mbledhjeve të thirrura, procedurën e votimit për qëllim të vendimmarrjes dhe zbatimin e vendimeve.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet nga të gjitha organet kolegjiale të OMK-së për zhvillimin e procedurave vendimmarrëse.
2. Kjo Rregullore përfshin dispozita të veçanta që zbatohen ekskluzivisht nga Kuvendi i Odës për shkak të kompetencave të veçanta të Kuvendit, si organi më i lartë i Odës. Dispozitat e veçanta përkitazi me punën e Kuvendit të Odës nuk zbatohen për organet e tjera të Odës.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Termat dhe akronimet të përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
  - 1.1 **Organi** – nënkupton organet kolegjiale që përkufizohen si autoritete që përbëhen nga dy e më shumë persona të zgjedhur, që ushtrojnë autorizimet e bazuara në ligj, Statutin e Odës dhe aktet e tjera normative;

- 1.2 **Organet individuale** – janë autoritete me kompetenca juridike të bazuara në ligj, Statut dhe aktet normative të Odës, që ushtrohen nga personi i vetëm i zgjedhur;
  - 1.3 **Konflikti i interesit** – nënkupton rrethanën në të cilën anëtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të funksionit të tij zyrtar.
  - 1.4 **Kryesuesi i mbledhjes** – nënkupton kryetarin, zëvendëskryetarin apo personin e autorizuar, i cili drejton mbledhjen e organit;
  - 1.5 **OMK** – nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;
2. Termat dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

## **Kapitulli II – Organizimi i brendshëm i organeve**

### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të organeve**

1. Anëtarët e organeve të Odës kanë këto të drejta dhe përgjegjësi :
  - 1.1 Të marrin pjesë në mbledhjet e organit;
  - 1.2 Të paraqesin propozimet e tyre në përputhje me procedurat e parapara me këtë Rregullore;
  - 1.3 T'u përmbahen rendit dhe rregullit të mbledhjeve;
  - 1.4 T'u ofrohen dokumentet dhe materialet e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre; dhe
  - 1.5 Të ndërmarrin veprime të tjera që janë të parapara me aktet normative të Odës.
2. Shërbimi profesional i Odës do të ofrojë asistencë profesionale për punën e organeve të Odës dhe anëtarëve të tyre.

### **Neni 5**

#### **Organet drejtuese**

1. Organet e Odës drejtohen nga kryetari dhe zëvendëskryetari, të cilët zgjidhen nga radhët e anëtarëve të organeve.
2. Kryetari dhe zëvendëskryetari i organit janë organe individuale në kuadër të organit kolegjal që kanë funksion drejtues brenda fushëveprimit të organit.

3. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen për një mandat 4 (katër)-vjeçar në përputhje me mandatin e Kuvendit të Odës.
4. Të gjitha veprimet procedurale që nevojiten të ndërmerren në drejtim për vendosjen mbi çështjen e caktuar, organet kolegjiale do të veprojnë sipas rregullave të përcaktuara në këtë.

## **Neni 6**

### **Zgjedhja e organeve drejtuese të organeve kolegjiale**

1. Kryetari i organit kolegjial zgjidhet nga radhët e anëtarëve të organit gjegjës. Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e organeve kolegjiale zgjidhen nga anëtarët e organit gjegjës vetëm nëse nuk është paraparë ndryshe në Rregulloren për procedurat e kandidimit dhe mënyrat e zgjedhjes së organeve të OMK-së.
2. Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e organeve kolegjiale zgjidhen në bazë të propozimeve dhe vetëpropozimeve të paraqitura nga anëtarët e organit gjegjës kolegjial, në mbledhjen e parë pas zgjedhjes së organit kolegjial, sipas procedurave zgjedhore të parapara me aktin e veçantë normativ mbi zgjedhjet e brendshme.
3. Votimi për zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit mund të bëhet në mënyrë të fshehtë dhe të hapur. Për mënyrën e votimit vendoset me votimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të organit kolegjial, me anë të votimit të hapur.
4. Në rast se për postin e kryetarit apo zëvendëskryetarit janë paraqitur më shumë se dy propozime, në raundin e parë të votimit kandidati duhet të fitojë më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të organit. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk fiton votat e mjaftueshme në raundin e parë, do të organizohet raundi i dytë i votimit, në të cilin votohen dy kandidatët më të votuar në raundin e parë. I zgjedhuri në raundin e dytë do të konsiderohet kandidati që ka fituar shumicën e votave të anëtarëve, të cilët kanë votuar dhe që kanë përmbushur kuorumin e mbledhjes.
5. Në çdo rast kur për postin e kryetarit apo zëvendëskryetarit kandidojnë vetëm një apo dy kandidatë, i zgjedhur do të konsiderohet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të anëtarëve që kanë votuar dhe që kanë përmbushur kuorumin e mbledhjes.

## **Neni 7**

### **Mënyrat e veçanta të zgjedhjes së organeve drejtuese**

1. Përrjashtëmishit dispozitave të tjera në këtë Rregullore, mënyra e zgjedhjes së kryesimit të organeve nuk zbatohet për organet, kryesimi i të cilave bëhet në bazë të funksionit, si në rastin vijues:
  - 1.1 Kuvendi i Odës kryesohet nga kryetari i Odës dhe 2 (dy) zëvendëskryetarë të Odës; dhe

- 1.2 Këshilli Drejtues kryesohet nga kryetari i Odës dhe një zëvendëskryetar i Këshillit Drejtues, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Drejtues me propozim të kryetarit të Odës, sipas rregullave të përgjithshme që janë paraparë me këtë Rregullore.
2. Po ashtu, përjashtim nga mënyra e zgjedhjes së kryesimit të organeve që është paraparë me këtë Rregullore, janë kryetarët dhe zëvendëskryetarët e organeve të mëposhtme që zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Kuvendi i Odës:
  - 2.1 Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës;
  - 2.2 Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Etik; dhe
  - 2.3 Kryetari dhe zëvendëskryetari i Gjyqit të Nderit.
3. Dispozitat e tjera të kësaj Rregulloreje janë të zbatueshme në tërësi sa u përket mënyrave të thirrjes së mbledhjeve, procedurave që duhet zhvilluar, si dhe mënyrës së vendimarrjes.

## **Neni 8**

### **Kompetencat e kryetarit të organit**

1. Kryetari i organit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 1.1 Thërret mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme;
  - 1.2 Kujdeset për zbatimin e plotë të procedurave të parapara me këtë Rregullore;
  - 1.3 Përpilon dhe propozon rendin e ditës për trajtimin e çështjeve;
  - 1.4 Kujdeset për rregullsinë e mbajtjes së mbledhjes dhe rendit në të;
  - 1.5 Kryeson mbledhjet e thirrura sipas kësaj Rregulloreje;
  - 1.6 Në mungesë të zëvendëskryetarit, autorizon njërin nga anëtarët e organit për të drejtuar mbledhjen;
  - 1.7 Interpreton dispozitat e kësaj Rregulloreje; dhe
  - 1.8 Kujdeset për çështje të tjera që janë të nevojshme për funksionimin e organit.
2. Në rast të mungesës së kryetarit, të gjitha kompetencat nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i ushtrojë zv. kryetari i Komisionit.

## **Neni 9**

### **Mandati i anëtarëve të organeve**

1. Anëtarët e organeve kanë mandat 4 (katër)-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat në vazhdim.
2. Mënyra e zgjedhjes, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të organeve rregullohet me akt të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të OMK-së.
3. Anëtarëve të organeve mund t'u ndërpritet mandati para përfundimit të tij të plotë, për shkaqet si në vijim :
  - 1.1 Me shkarkim nga organi që i ka zgjedhur;
  - 1.2 Me dhënie të dorëheqjes me shkrim;
  - 1.3 Në rast të shqiptimit të masës disiplinore sipas vendimit të Këshillit Etik;
  - 1.4 Nëse pa arsye mungojnë 3 (tri) herë radhazi në mbledhjet e rregullta të organit;
  - 1.5 Me humbjen e statusit të anëtarit të OMK-së; dhe
  - 1.6 Me vdekjen e anëtarit të Komisionit.
  - 1.7 Si dhe me rastin e ndrrimit të vendit të punës dhe peniosnimit të anëtarit.
4. Anëtari i larguar nga organi zëvendësohet në pajtim me aktin e veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të OMK-së apo rregullave të parapara me këtë Rregullore.

## **Neni 10**

### **Mbledhjet e organeve**

1. Organet e OMK-së mbajnë mbledhje sipas nevojave dhe kërkesave të parashtruara lidhur me çështjet që janë në kompetencë të tyre. Secili organ i Odës është i obliguar që të paktën të mbajë mbledhje çdo 3 (tre) muaj. Përrjashtim nga ky rregull përbën Kuvendi i Odës, për të cilin janë paraparë dispozitat e veçanta lidhur me mbarëvajtjen e mbledhjeve të tij.
2. Organet mbajnë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme që thirren sipas mënyrës së paraparë me këtë Rregullore.
3. Mbledhja e rregullt e organit thirret nga kryetari i Komisionit, përkatësisht nga zv. kryetari në rast të mungesës së kryetarit apo me autorizimin e tij.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nga kryetari i organit apo me kërkesën e 1/2 së anëtarëve të organit.

5. Ftesa për mbledhje me rendin e propozuar të ditës u dërgohet anëtarëve të organit së paku tri ditë më herët. Ndërkaq ftesa për mbledhje të jashtëzakonshme me rendin e propozuar të ditës u dërgohet anëtarëve të organit, së paku 24 orë më herët.
6. Në çdo mbledhje të organit evidenca e rrjedhës procedurale të mbledhjes mbahet në procesverbalin e mbledhjes.

### **Neni 11** **Procesverbalet**

1. Për punën dhe rrjedhën e mbledhjeve të organeve mbahet procesverbali i veçantë i mbledhjes.
2. Procesverbali përmban të dhënat kryesore mbi rrjedhën e mbledhjes, mbi rendin e ditës, mbi shqyrtimet dhe diskutimet, si dhe për votimet dhe vendimet e miratuara.
3. Procesverbali domosdo përmban edhe rezultatet e votimit për çështje që janë vendosur në procedurë të votimit.

### **Neni 12** **Kuorumi dhe vendimmarrja**

1. Mbledhjet e organit kanë kuorum nëse në të janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të organit gjegjësis.
2. Prania e anëtarëve të organit verifikohet me ngritje të dorës dhe numërimin të tyre. Konstatimi i anëtarëve të pranishëm në mbledhje të organit bëhet nga kryesuesi i mbledhjes. Konstatimi i tillë shënohet në procesverbal.
3. Në mungesë të kuorumit, kryesuesi i mbledhjes e ndërpret mbledhjen deri në caktimin e takimit të radhës duke konstatuar rrethanën e tillë në procesverbalin e mbledhjes së thirrur.
4. Për çështjet në të cilat organi vendos në procedurë të votimit, vendosja bëhet me shumicë të thjeshtë të votave pas konstatimit të kuorumit në mbledhjen e thirrur në përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Rregullore.
5. Në rast se kemi numër të barabartë votash, atëherë vendos vota e kryesuesit të organit.
6. Votimi në procedurat vendimmarrëse të organeve bëhet në këto mënyra:
  - 6.1 votimi i hapur, me ngritje të dorës: “për”, “kundër” dhe “abstenim”,
  - 6.2 votimi i fshehtë ose
  - 6.3 Votim qarkullues apo i regjistruar, që e përfshin votimin me shkrim apo elektronik dhe
  - 6.4 Votimin duke e thirrur secilin anëtar të organit veç e veç.

### **Neni 13** **Konflikti i interesit**

1. Nëse një anëtar ka konflikt interesi me një çështje që paraqitet për shqyrtim në organ, ai nuk merr pjesë në mbledhje deri në vendosje për çështjen, e cila paraqitet si rrethanë e konfliktit të interesit.
2. Në rastet e paraqitjes së rrethanave që përbëjnë konflikt të interesit, anëtari i organit, i cili gjendet në kushte të tilla, është i obliguar që të deklarojë rrethanën e tillë në momentin që është në dijeni për këtë çështje.
3. Secili nga anëtarët, kur është në dijeni se ndonjëri nga anëtarët e organit është në konflikt të interesit, është i obliguar që të deklarojë konfliktin e interesit të cilitdo anëtar të Komisionit.
4. Për çështjet më të hollësishme përkritazi me konfliktin e interesit do të zbatohen në përshtatje dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
5. Për zbatimin e kësaj dispozite do të kujdeset kryetari i organit.

### **Kapitulli III – Rrjedha dhe rendi i mbledhjeve**

#### **Neni 14** **Hapja e mbledhjes**

1. Mbledhjen e thirrur të organit e hap kryesuesi i mbledhjes, i cili në fjalën hyrëse konstaton hapjen e mbledhjes, për të vazhduar sipas radhës së mëposhtme të paraparë me dispozita të këtij neni.
2. Kryesuesi i mbledhjes pas fjalës hyrëse, në rast se nuk është i përcaktuar procesmbajtësi i përhershëm, ia propozon organit personin që do të mbajë evidencën dhe të njëjtën do ta transkriptojë. Procesmbajtësi zgjidhet me votën e shumicës së anëtarëve të pranishëm që përmbushin kuorumin.
3. Kryesuesi i mbledhjes, pas procedurës paraprake të hapjes formale të mbledhjes dhe zgjedhjes së procesmbajtësit, konstaton kuorumin e mbledhjes në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
4. Kryesuesi i seancës, pasi ta ketë konstatuar kuorumin e seancës, do ta hedhë në votim procesverbalin e mbledhjes paraprake. Para votimit të procesverbalit, nëse ka ndonjë vërejtje, kryesuesi i mbledhjes do t'ua japë mundësinë anëtarëve të organit që të paraqesin vërejtjet e tyre për procesverbalin e mbledhjes.
5. Në rast se anëtarët e organit parashetrojnë vërejtjet e tyre dhe për pretendimet e tilla nuk paraqiten kundërshtimet nga anëtarët e tjerë që janë të pranishëm, kryesuesi i mbledhjes do të



hedhë në votim procesverbalin me vërejtjet e parashtruara. Procesverbali me apo pa vërejtjet e paraqitura miratohet me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm që përmbushin kuorumin.

6. Nëse ndaj vërejtjeve të paraqitura nga anëtarët e organit lidhur me procesverbalin paraqiten kundërshtime, atëherë kryesuesi vërejtjen e kundërshtuar do ta hedhë në votim të veçantë, dhe, varësisht nga miratimi apo refuzimi, vërejtja e tillë futet në procesverbal.

### **Neni 15** **Rendi i ditës**

1. Kryesuesi i mbledhjes, pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes paraprake, konstaton se anëtarëve u është dërguar rendi i ditës së bashku me materialet përcjellëse dhe më pas e hedh në votim rendin e ditës, i cili konsiderohet se është miratuar me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm që përmbushin kuorumin.
2. Kryesuesi i mbledhjes do t'u japë mundësi anëtarëve që të deklarohen dhe të paraqesin propozimet e tyre lidhur me rendin e ditës. Çdo propozim i paraqitur duhet që të aprovohet nga mbledhja e organit, nga shumica e anëtarëve të pranishëm që përmbushin kuorumin.
3. Diskutimi gjatë shqyrtimit të rendit të ditës kufizohet në kohëzgjatje prej 3 (tre) minutave.
4. Rendi i ditës për mbledhjen e jashtëzakonshme nuk i nënshtrohet miratimit nga Kuvendi i Odës dhe si i tillë nuk mund të ndryshohet me propozimin e anëtarëve të Kuvendit.

### **Neni 16** **Shqyrtimi në mbledhje**

1. Shqyrtimi në mbledhje fillon sipas renditjes së përfshirë në rendin e miratuar të ditës.
2. Kryesuesi i mbledhjes deklaron hapjen e shqyrtimit të çështjes sipas pikës së rendit të ditës të aprovuar nga organi. Nëse për pikën e rendit të ditës për të cilën ka filluar shqyrtimi ekziston materiali përcjellës, kryesuesi i mbledhjes prezanton materialin në fjalë. Me kërkesë të anëtarëve të organit, mund të kërkohej nga kryesuesi i mbledhjes që të lexojë materialin ose një pjesë të caktuar të tij.
3. Pas prezantimit të pikës së rendit të ditës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, kryesuesi i mbledhjes hap diskutimin për pikën e rendit të ditës. Anëtarët e interesuar për diskutim lajmërohen për të folur. Diskutimi i anëtarit kufizohet në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) minutave. Në raste kur anëtari kërkon fjalën për herë të dytë brenda shqyrtimit të pikës së njëjtë të rendit të ditës,

kryesuesi mund ta kufizojë këtë deklaram për shkak të azhurnimit të kohës, por jo ta shkurttojë në kohë më të shkurtër se 2 (dy) minuta.

4. Gjatë diskutimit të tyre anëtarët janë të obliguar që t'i përmbahen rendit të ditës. Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen anëtarit dhe të kërkojë nga ai që t'i përmbahet diskutimit lidhur me pikën e rendit të ditës. Nëse anëtari nuk i bindet vërejtjes së kryesuesit, ndaj tij mund të merren masat që janë të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
5. Anëtarët e organit kanë të drejtë në replikë në rast se përmendet emri i tyre gjatë fjalimit nga anëtari i organit. E drejta në replikë mund të kërkohet menjëherë pas përfundimit të fjalimit në të cilin anëtari ia ka përmendur emrin replikuesit. Replika kufizohet në kohëzgjatje prej 2 (dy) minutash.
6. Anëtari, diskutimi i të cilit është replikuar, sipas paragrafit 4 të këtij neni, ka të drejtë në kundërreplikë në kohëzgjatje prej 1 (një) minute, me kusht që këtë ta ketë kërkuar menjëherë pas replikës.
7. Pas përfundimit të diskutimeve të paraqitura nga anëtarët e organit, kryesuesi i mbledhjes konstaton se diskutimi është përmbyllur për atë pikë të rendit të ditës.
8. Varësisht nga natyra dhe përmbajtja e pikës së rendit të ditës, kryesuesi i mbledhjes do t'i hedhë në votim propozimin e konkluduar, aktin juridik të diskutuar në pikë të rendit të ditës, apo propozimet e parashtruara gjatë diskutimit për pikën e rendit të ditës.

## **Neni 17**

### **Procedura e parashtrimit të propozimeve për draftimin e akteve**

1. Në rastet e draftimit të akteve të ndryshme juridike, anëtarëve të organit do t'u ofrohet materiali të paktën 7 (shtatë) ditë para mbajtjes së mbledhjes.
2. Anëtarët e organeve janë të obliguar që propozimet e tyre t'i paraqesin në formë të shkruar jo më vonë se 2 (dy) ditë para mbajtjes së mbledhjes së thirrur, në të cilën do të shqyrtohet akti i cili procedohet për miratim.
3. Për shqyrtim nga organi do të merren parasysh vetëm propozimet e parashtruara në formë të shkruar, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
4. Propozimet e parashtruara do të shqyrtohen dhe miratohen në mënyrë të veçantë në formën e votimit siç është paraparë me këtë Rregullore.
5. Propozimet në formë të shkruar anëtarët i dërgojnë përmes postës elektronike në adresën zyrtare të Odës.

## **Neni 18**

### **Rendi dhe qetësia në mbledhje të organeve**

1. Asnjë anëtar i organit nuk mund ta marrë fjalën pa lejen e kryesuesit të mbledhjes.
2. Anëtarët e organit gjatë diskutimeve të tyre duhet të përmbahen nga fjalori ofendues dhe fjalori i papërshtatshëm.
3. Në raste të mosrespektimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje, kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen anëtarit për prishjen e rendit dhe të qetësisë në mbledhje.
4. Nëse anëtari i organit nuk i bindet vërejtjes së dhënë, kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që:
  - 4.1 Të kërkojë nga anëtari që të tërheqë fjalën;
  - 4.2 Të kërkojë nga anëtari që të kërkojë falje për fjalorin e papërshtatshëm dhe ofendues të përdorur nga ai;
  - 4.3 T'ia ndërpresë fjalën;
  - 4.4 Të kërkojë që ta lëshojë mbledhjen; dhe
  - 4.5 Të iniciojë procedurën disiplinore në Gjyqin e Nderit ndaj anëtarit të Kuvendit për shkak të sjelljes së pahijshme dhe prishjes së rendit dhe të qetësisë në mbledhje.

## **Kapitulli IV – Dispozita të veçanta mbi punën e Kuvendit të Odës**

### **Neni 19**

#### **Mbledhja konstitutive**

1. Mbledhja konstitutive thirret nga kryetari i Odës, nga mandati i kaluar, në afat prej së largu 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).
2. Ftesa dhe rendi i ditës u dërgohet anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e mbajtjes së mbledhjes konstitutive.
3. Kryesimi i mbledhjes konstitutive deri në përfundimin e procesit të zgjedhjes së kryetarit dhe 2 (dy) zëvendëskryetarëve të Odës bëhet nga kryetari i Odës, nga mandati i kaluar, i ndihmuar nga dy anëtarë të Kuvendit më të rinj në moshë.
4. Mbledhja konstitutive konsiderohet e përfunduar me zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarëve të Odës.

## **Neni 20**

### **Rrjedha e mbledhjes konstitutive**

1. Kryesuesi i mbledhjes konstitutive hap mbledhjen duke e deklaruar në mënyrë solemne fillimin e punimeve të Kuvendit.
2. Pas hapjes së mbledhjes kryesuesi verifikon numrin e anëtarëve të pranishëm në mbledhjen konstitutive. Mbledhja konstitutive ka kuorum nëse janë të pranishëm të paktën 2/3 e të gjithë anëtarëve që kanë fituar mandatin sipas rezultatit të certifikuar të KQZ-së.
3. Kryesuesi i mbledhjes konstitutive konstaton përmbushjen e kuorumit sipas paragrafit 2 të këtij neni. Pas konstatimit të kuorumit kryesuesi propozon procesmbajtësin dhe një verifikues të procesverbalit, të cilët votohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm e që përmbushin kuorumin.
4. Pas votimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, kryesuesi thërret kryetarin e KQZ-së që të bëjë leximin e emrave të anëtarëve që kanë fituar mandatin sipas rezultatit të certifikuar.

## **Neni 21**

### **Betimi i anëtarëve të Kuvendit**

1. Pas verifikimit të mandateve, anëtarët e Kuvendit të Odës betohen solemnisht, duke u ngritur dhe duke qëndruar në këmbë deri në leximin e tekstit të deklaratës nga kryesuesi, si në vijim:

*“Unë, anëtar i Kuvendit të Odës së Mjekëve të Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do t’i përfaqësoj me dinjitet interesat profesionale të anëtarëve të Odës, do të promovoj dhe do të mbroj veprimtarinë profesionale shëndetësore, dhe do të kontribuoj në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor”. Betohem!*

2. Pas betimit, anëtarët e Kuvendit e nënshkruajnë deklaratën e betimit, të cilën menjëherë duhet t’ia dorëzojnë Shërbimit Profesional të Odës.
3. Me dhënie të betimit konsiderohet se anëtarët e Kuvendit fitojnë autorizimin për të ushtruar funksionin e anëtarit të Kuvendit sipas kompetencave të parapara me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme normative të Odës.

## **Neni 22**

### **Mandati i Kuvendit**

1. Mandati i Kuvendit të Odës është 4 (katër)-vjeçar.
2. Mandati i Kuvendit fillon të rrjedhë nga dita e konstituimit të Kuvendit sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

3. Mandati i Kuvendit të Odës mbaron në të njëjtin muaj kur është mbajtur mbledhja konstitutive e Kuvendit.
4. Zgjedhjet për Kuvendin e Odës mbahen në një afat jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të mandatit, respektivisht ditës së fundit të muajit në të cilin përfundon mandati i Kuvendit, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

### **Neni 23**

#### **Kuorumi dhe vendimmarrja**

1. Mbledhjet e Kuvendit kanë kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
2. Vendimet, aktet normative të përgjithshme, deklaratat, qëndrimet dhe rezolutat e Kuvendit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm dhe që përmbushin kuorumin sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Miratimi, ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Odës dhe Kodit Etik bëhet me votimin e 2/3 të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Odës.

### **Neni 24**

#### **Mbledhjet e Kuvendit**

1. Mbledhjet e Kuvendit mbahen sipas nevojës. Mbledhja e detyrueshme e Kuvendit duhet të mbahet së paku 1 (një) herë në vit.
2. Mbledhjen e Kuvendit e fton kryetari i Odës, si kryesues i Kuvendit sipas detyrës zyrtare.
3. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme i thërret kryetari i Odës, Këshilli Drejtues dhe sipas kërkesës së nënshkruar nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
5. Ftesa, së bashku me rendin e ditës dhe materialin përcjellës, u dërgohet anëtarëve të Kuvendit në mënyrë elektronike, së paku 7 (shtatë) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes së thirrur.
6. Afati për dërgimin e ftesës, rendit të ditës dhe materialit përcjellës për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit është 3 (tri) ditë nga dita para mbajtjes së mbledhjes së jashtëzakonshme të thirrur.
7. Të gjitha dispozitat lidhur me kompetencat e kryesuesit të mbledhjes, rrjedhën dhe rendin në mbledhje të organeve të Odës, do të zbatohen në përshtatshmëri me mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit.

## Neni 25

### Procedura e parashtrimit të propozimeve për draftimin e akteve normative

1. Në rastet e draftimit të akteve të ndryshme juridike që shqyrtohen nga Kuvendi i Odës, anëtarëve të Kuvendit do t'u ofrohet materiali të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbajtjes së mbledhjes.
2. Anëtarët e organeve janë të obliguar që propozimet e tyre t'i paraqesin në formë të shkruar jo më vonë se 5 (pesë) ditë para mbajtjes së mbledhjes së thirrur në të cilën do të shqyrtohet akti i cili procedohet për miratim.
3. Për shqyrtim nga Kuvendi do të merren parasysh vetëm propozimet e parashtruara në formë të shkruar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
4. Propozimet e parashtruara do të shqyrtohen dhe miratohen në mënyrë të veçantë në formën e votimit siç është paraparë me këtë Rregullore.
5. Propozimet në formë të shkruar anëtarët e Kuvendit i dërgojnë përmes postës elektronike në adresën zyrtare të Odës.

## Neni 26

### Përshtatshmëria e zbatimit të dispozitave të tjera

Kuvendi i Odës do të zbatojë të gjitha dispozitat e tjera të parapara me këtë Rregullore në mënyrë të përshtatshme me dispozitat e veçanta që janë paraparë për punën e tij.

## Kapitulli V - Dispozitat përfundimtare


### Neni 27

#### Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat mbi punën e organeve të Odës që bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së

Prishtinë 15 qershor 2021,

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdu, m.r.sci



Page 14 nga 14